

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Mbyllja e unazes midis F12 dhe F15 Nst Fieri i ri, ndertimi i kabinave, Mbyet 2, box e re drejtim Levanit dhe kabine e re shtyllore Stallat e derrave, rrjeti TU me ABC ne Fiderin Pularia 1 Nenstacioni Fier 1, 35/6kV dhe rrjeti TU me ABC i kabinave ne ish komunen Frakull dhe Cakran”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45231400-9 Puna e ndërtimit për linjat e energjisë elektrike

VLERA E FONDIT LIMIT: 69,980,729.05 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzet e nëntë presje zero pesë) lekë pa tvsh, vënë në dispozicion nga te ardhurat e shoqërisë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës nr. 3

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kritereve të Përgjithshme (Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të certifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit financiare (2023, 2024) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i

ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2.2. Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur të kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor). Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e përlllogaritur e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. (neni 43, pika 2, germa "b" VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar)

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" ku citohet: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.2.3. 2.2.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2025 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Për të përmbushur kërkesën e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 26 pika 6, dokumentacioni provues i përcaktuar mësipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në lidhje me kërkesën për pagesën e taksave vendore referojmë se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i ndryshuar).

Me anë të kriterit për të paraqitur dokumentacionin e shlyerjes së taksave vendore kërkohej që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se ushtrojnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se **200%** e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë. Për kontrata të realizuara me ente publike, Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer)
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Aktin e kolaudimit
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore **të deklaruara në organet tatimore** dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Fatura tatimore përkatëse të deklaruara në organet tatimore
- Aktin e kolaudimit

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, sipas parashikimeve të nenit 88 pika 3 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë

të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Ndërsa pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3 i VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar)

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Kontratën e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të jenë të pajisur me licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të kategorive

- | | | |
|--------------------------|--|----------------------|
| • Kategoria NP- 1 | Punime gjurmimi në tokë | Klasifikimi A |
| • Kategoria NP-11 | Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve
linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë | Klasifikimi C |
| • Kategoria NS-8 | Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike | Klasifikimi A |

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Ne rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kusht duhet të plotësohet nga operatori ekonomik i cili ka marrë përsiper punimet për të cilat kërkohet kjo licencë

Argumentimi: Licencat profesionale përputhen me natyrën, përmasat dhe vlerën e punimeve të objektit të kontratës. Keto licenca dëshmojnë aftësinë profesionale të shoqërisë për zbatimin me sukses të kontratës. Klasifikimi i kategorisë është kryer sipas vlerës së punimeve konkrete në projekt-preventiv. Kërkesa për keto licenca profesionale është percaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162 të datës 23.12.2020 “Per Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 39, pika 6/a, të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Per miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Llojet e licensave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të punimeve për këtë objekt si me poshte:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P-1	Punime germimi në toke	Germim gropash shtyllash	A	0-20 milion leke
N.P-11	Ndërtime për N/stacione, kabina, transformatore, linja TN e të mesme dhe shpërndarje energjise	Punime izolimi, demontim përcjellesi, F.V kabell ABC + aksesori F.V kabell furnizimi abonentesh + aksesori	C	51-100 milion lekë

NS-8	Ndërtimë parafabrikat beton arme, struktura metalike	Montim "Box" parafabrikat (21+1t) (box parafabrikat perfshin: kabinen parafabrikat me permasa 4.2X2.2, h=2.2m, bazamentin e kabines 4.2X2.2,h=0.6m, setin e pajisjeve TM / TU,tokezimi I brendeshem, ndricimi pa transformatorin e fuqise)	A	0-20 milion leke
------	--	---	---	------------------

2.3.3. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht 30 (tridhjetë) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, shoferë, manovratorë, stafi teknik) për periudhën Gusht - Tetor 2025, i lëshuar nga Administrata Tatimore.
- Listëpagesat për periudhën Gusht - Tetor 2025, sipas formatit të miratuar nga Administrata Tatimore.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Numri i punonjësve është kërkuar duke ju referuar përmasave dhe specifikës së Investimit që do të kryhet. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve është mbajtur në konsideratë natyra e punimeve,volumi i punimeve, zona gjeografike që mbulon ky investim i parashikuar, afati i kryerjes së tyre duke përfshirë këtu edhe numrin total të punonjësve (Inxhinierë, teknikë, specialist, punonjës të kualifikuar, punëtorë të thjeshtë, punëtorët e mjeteve të rënda apo të thjeshta etj), e lidhur kjo me të vetmin qëllim të zbatimit të tij sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Ky kriter përmbushet nepermjet paraqitjes nga Operatoret Ekonomik te Formularit Permbledhes te Vetdeklarimit, sipas shtojces nr. 8 te DST-ve.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, të cilat duhet të jenë në original ose në kopje të njësuara me originalin..... (neni 26 i VKM, i ndryshuar)

2.3.4. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të kenë stafin e tyre teknik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune, diplomë, certificate/dëshmi kualifikimi të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial / ekuivalente, librezë pune, CV për 1 (një) inxhinier ndërtimi dhe 1 (një) inxhinier elektrik. Stafi i mësipërm duhet të figurojë në licensën e shoqërisë.
2. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) **Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem si dhe të ketë eksperiencë pune.
 - Libreze pune (perkatëse)
 - CV perkatëse
 - Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
 - Diplomë
3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimit nga një organizëm i akredituar/licencuar /certifikuar shqiptar ose i huaj për 1 (një) ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M. nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.
4. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe certifikatë të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial/ekuivalente dhe të vlefshme për 2 (dy) punonjës elektrikist (Kategoria IV) ose me lartë pjesa tjetër të jenë të pajisur me IQT për elektrikist, 10 (dhjetë) Elektriciste (Kategorite II dhe III), 2 (dy) Automakinistë (leje drejtimi perkatëse) dhe 2 (dy) shoferë leje (drejtimi perkatëse). Stafi i mësipërm, duhet të jetë i listuar në Listëpagesat e operatorit ekonomik të paktën gjatë periudhës Gusht - Tetor 2025 dhe të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të vlefshme, të lëshuara nga shoqëri të akredituara në bazë të Ligjit Nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, i ndryshuar.

Në rastin kur punonjësit automakinistë apo shoferë janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listëpagesat e Shoqërisë

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar, i pari duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).*

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike. Nevoja për inxhinierë në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Ne lidhje me aftësitë teknike, Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën sipas nje standarti të pershtatshem cilesie.

Per sa me siper, eshte e nevojshme qe Operatorete Ekonomike te pasqyrojne referenca te pershtatshme nga kontratatata te zbatuara ne te shkuaren nga ana e tyre.

- **Inxhinieri i Ndertimit:** eshte pergjegjes per punimet civile qe kane te bejne me betonimet e shtyllave, te linjave TM/TU ne objekt, siguron dhe zbatimin e kushteve te sigurise.
- **Inxhinieri Elektrik:** eshte pergjegjes per zbatimin e projektit te miratuar, sipas kushteve teknike per punime ne linja dhe kabina elektrike percaktuar sipas Rregullores se Shfrytezimit dhe Sigurimit Teknik.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Kriteri i punësimit të një inxhinieri elektrik si drejtues teknik me licencë është i rëndësishëm për disa arsye. Me qëllim ndërtimin e objektit te vepres sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qënë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është e konsiderueshme dhe parësore për objektin në përgjithësi në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”,

njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, të përfshirë në liçensimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Drejtuesi teknik duhet të disponojë kualifikimet e kërkuara, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*.

Vendosja e një inxhinieri elektrik si drejtues teknik siguron që puna do të kryhet në përputhje me standardet teknike dhe me kujdesin e duhur për sigurinë e punonjësve dhe të mjedisit. Ky kriter ndihmon në garantimin e cilësisë së punëve. Inxhinieri elektrik si drejtues teknik është përgjegjës për monitorimin e punimeve dhe menaxhimin e situatave teknike që mund të dalin gjatë zbatimit. Kërkesa për të siguruar që inxhinieri elektrik është i regjistruar dhe i siguruar në listat e pagesave të sigurimeve për një periudhë të caktuar siguron se operatori ekonomik respekton të gjitha detyrimet legjislative dhe siguron që punonjësit janë të mbrojtur në rast të ndonjë aksidenti ose dëmtimi. Eshtë kërkuar te kete ne staf Inxhinier Ndërtimi, i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e preventivit të punimeve per anen ndertimore kryesisht per ndertimin e bazamentit te kabines box, ndertimin e bazamentit te shtyllave te betonit, per punime civile, rikthimin ne gjendjen e meparshme te rruges dhe percaktimin e shtresave perberese te saj etj.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e duhur për të dëshmuar që ka përmbushur këtë kriter. Ky dokumentacion përfshin kontraten individuale të punës, diplomën e inxhinierave, CV, librezë pune dhe liste pagesa.

Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për 1 (një) ekspert që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 *“Për Prokurimin Publik”* (i ndryshuar), Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, *“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.”*.

Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit.

Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Eksperti që përmbush kriteret për të qenë koordinator në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve duhet të jete ne kantier per minizimin e aksidenteve ne pune.

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

- Numri i fuqisë punetore u llogarit duke u bazuar ne volumin e punimeve qe duhen kryer sipas projekt-preventivit dhe afatit 120 ditë per kryerjen e punimeve. Ne baze te oreve te punes te marra nga analizat per secilin ze, u llogarit shifra prej 30 punonjës.
- Komisioni vlerëson se te pakten 12 punonjes duhet te jene pajisur me kartela personale te sigurimit teknik, të leshuara nga Inspektoriati Qendror Teknik ose nga organi kompetent ne baze te ligjit nr. 8734, date 01.02.2001 dhe ligjit Nr.13/2013, date 14.02.2013, te cilet të jenë elektrikist dhe me deshmime perkatese te formimit.
Keto deshmi duhet te kerkohen per shkak te natyres se punimeve ,punonjesit duhet të kenë njohuri të plota mbi elektroteknikën, njohuri të plota të Rregullores së Sigurimit Teknik Elektrik, mbi rregullat e përdorimit të mjeteve mbrojtëse që përdoren në linjat elektrike. Gjithashtu të kenë njohuri mbi impiantet elektrike (linjën elektrike), që të jenë të aftë për caktimin, se cilat elemente duhet të hapen për kryerjen e punimeve, dhe të dijë të veprojnë në zbatimin e masave të domosdoshme të sigurimit teknik elektrik.
- Operatori Ekonomik duhet te kete ne stafin e tij dhe te figurojne ne listepagesat e shoqerise: 1(nje) Inxhinier Elektrik dhe 1 (nje) Inxhinier Ndertimi, qe te mbikeqyrin punimet ne fazen e zbatimit. Keta inxhinier kane lidhje edhe me licencat profesionale qe duhen per zbatimin e projektit.
- Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës.

2.3.5. Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve si më poshtë:

- **Shtylla b.a.c centrifugale**
- **Ndaresa, shkarkues, siguresa TM**
- **Tranformator Fuqie**
- **Panele TU**
- **Tel Al-C**
- **Kabllo TU**
- **Kabllo ABC**
- **Aksesori për linjat ABC**
- **Terminale dhe mufte TM**
- **Cela TM**
- **Kabllo TM**
- **Kabina box parafabrikat**

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë:

- a. Autorizim të Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
- b. Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.
Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) të pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi:

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave.

Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së mallit të sipercituar.

Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, AK mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plotë të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktojë me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara.

Paraqitja e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që AK ka një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave.

Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike.

Gjithashtu kriteri për përkthimin e specifikimeve teknike në shqip është i rëndësishëm për garantimin e një komunikimi të qartë dhe të kuptueshëm me Autoritetin Kontraktor në cilësinë e blerjes. Përkthimi i specifikimeve teknike në shqip siguron Autoritetin Kontraktor të kenë një kuptim të saktë të cilësive dhe karakteristikave të mallrave. Kjo ndihmon në zvogëlimin e gabimeve dhe keqkuptimeve të mundshme gjatë furnizimit të mallrave.

2.3.6. Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:

1. Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI ISO 9001-2015 e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
 2. Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI ISO 14001-2015 e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
 3. Certifikatën SSH/ EN/UNI ISO 45001:2018/45001-2023 e përditësuar, (SSH/DIN/EN/UNI ISO 45001 – 2023) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata te jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH/DIN/EN/UNI mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim:

Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”,* si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO

9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis të projektit si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

2.3.7. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion për të përmbushur kontratën. Konkretisht, mjetet e nevojshme për të përmbushur kontratën janë: 1 (një) copë kamion me vinc 5-10 ton, 1 (një) Autovinç 16 ton, 1 (një) automjet transporti mbi 7 ton, 1 (një) autobot uji, 1 (një) eskavator me goma, 2 (dy) vinc kullë, 1 (një) betoniere kantieri 500L, 1 (një) vibrator thellësie, 1 (një) kenotron kablli, 1 (një) kit komplet veglash pune dhe aparate për specialist linje, 1 (një) kit komplet veglash pune dhe aparate për linja tm, 1 (një) karrocë dore, zlitë metalike, dhe 1 (një) terraohm (aparat tokezimi).

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë leje e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit (vetëm për kamionët dhe kamionçinat), foto perkatëse ballore dhe anesore.

Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publike që merren me qira, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë kontratën e qirasë e vlefshme gjatë gjithë afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi. Bashkangjitur kontratës së qirase duhet të jenë leja e qarkullimit, çertifikata e pronësisë, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat vjetore, leja e transportit (vetëm për kamionët dhe kamionçinat), foto perkatëse ballore dhe anesore.

Për mjetet dhe pajisjet që nuk pajisen me leje qarkullimi operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë dokument të vlefshëm që vërteton pronësinë apo marrjen me qira të tij dhe foto perkatëse.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues i përcaktuar mesipër duhet të paraqitet pranë Autoritetit Kontraktor para lidhjes së marrëveshjes kuadër.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe të pranojë verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht:

Analizat e çmimeve të zerave të preventivit janë marrë në bazë VKM nr. 216 datë 13.04.2023, botuar në fletoren zyrtare Nr.66, datë 19.04.2023.

Analizat teknike që nuk janë në VKM Nr.216 datë 13.04.2023, janë hartuar si zëra jashtë liste bazuar në librin Nr.6 “Montimi i linjave dhe nestacioneve elektrike” si edhe në librin e “Normave komunale”

Çmimet e bazës materiale janë marrë në bazë të manualit të SAP-it-OSSH, studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga veteautoriteti Vendim nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.

Volumet e germimeve, betonimeve dhe të montimeve janë marrë sipas standarteve të OSSH Sh.a bashkëngjitur projektit.

Paga orare është marrë 484.90 Leke

Për punimet e montimit që nuk janë në manual i referohemi Udhezimit nr.2 datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Shpenzimet plotësuese janë marrë 8 % sipas VKM nr. 216 datë 13.04.2023, botuar në fletoren zyrtare nr.66 datë 19.04.2023

Norma e fitimit është marrë 10 % sipas VKM nr. 216 datë 13.04.2023, botuar në fletoren zyrtare nr.66 datë 19.04.2023.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike.

Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat të rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuesë, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Specifikimet teknike janë hartuar nga OSSH qender dërguar me e mail ne Drejtorine Rajonale Tirane e OSSH sh.a.

- Më pas u diskutuan të gjithë kapitujt e dokumentave të tenderit dhe Njësia e Prokurimit bëri miratimin e dokumentave të tenderit.
- Dokumentat u printuan dhe u firmosën në çdo faqe nga të gjithë anëtarët e Njesisë së Prokurimit.

NJESIA E PROKURIMIT

Personi përgjegjës

Specialist

Specialist